



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.20**

**Datë 17 mars 2006**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

|                                      |                                                                                                                                                                                                                          |     |
|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Ligj nr.9478<br>datë 16.2.2006       | Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në vendimet II/14 dhe III/7, amendamente të konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”.....                                             | 631 |
| Ligj nr.9479<br>datë 16.2.2006       | Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Maqedonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”.....                   | 635 |
| Ligj nr.9483<br>datë 16.2.2006       | Për një ndryshim në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....                                                                                                                     | 640 |
| Dekret nr.4805<br>datë 15.3.2006     | Për emërim<br>ambasadori.....                                                                                                                                                                                            | 640 |
| Vendim i KM<br>nr.134, datë 8.3.2006 | Për dhënien e lejes për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, si shkollë e mesme e përgjithshme, e profilizuar “Memorial International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze..... | 641 |
| Vendim i KM<br>nr.135, datë 8.3.2006 | Për procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore, për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive.....                                                                                            | 641 |
| Vendim i KM<br>nr.137, datë 8.3.2006 | Për përjashtimin nga tarifa e veçantë e shkollimit, në kuotat dytësore, për sistemin me kohë të plotë, të studentëve, që janë të verbër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë.....                                    | 642 |

|                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                          |     |
|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| Vendim i KM<br>nr.143, datë 8.3.2006 | Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Spanjës, për heqjen e ndërsjellë të vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit..                                                                                       | 643 |
| Vendim i KM<br>nr.144, datë 8.3.2006 | Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të sistemit arsimit<br>parauniversitar.....                                                                                                                                                                                  | 645 |
| Vendim i KM<br>nr.145, datë 8.3.2006 | Për disa ndryshime në vendimin nr.388, datë 31.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, funksionimin, të drejtat dhe detyrat e Komisionit Shtetëror të Prodhimit Organik”.....                                                                                                  | 646 |
| Vendim i KM<br>nr.147, datë 8.3.2006 | Për lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të institucioneve të varësisë, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore, për furnizimin me mjete didaktike, demonstrative dhe dokumentacion shkollor, sipas nevojave..... | 647 |

**L I G J**  
**Nr.9478, datë 16.2.2006**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË VENDIMET II/14 DHE III/7,  
AMENDAMENTE TË KONVENTËS SË ESPOO-S “PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT  
NË MJEDIS, NË KONTEKST NDËRKUFITAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

**Neni 1**

Republika e Shqipërisë aderon në vendimin II/14, amendament i Konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”.

**Neni 2**

Republika e Shqipërisë aderon në vendimin III/7, amendament i Konventës së ESPOO-s “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në kontekst ndërkufitar”.

**Neni 3**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4800, datë 10.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Alfred Moisiu**

**SHTOJCA VII**  
**VENDIMI III/7**  
**AMENDAMENTI I DYTË I KONVENTËS SË ESPOO-S**

Mbledhja,

*duke mbajtur parasysh* vendimin e saj 11/10 mbi rishikimin e Konventës dhe paragrafin 19 të Deklaratës Ministeriale të Sofies;

*duke dëshiruar* të ndryshojë Konventën me synim forcimin e mëtejshëm të zbatimit të saj dhe përmirësimin e raportit me marrëveshjet e tjera shumëpalëshe mjedisore;

*duke përgëzuar* punën e bërë nga grupi i punës i krijuar në mbledhjen e dytë të palëve, nga grupi i vogël mbi ndryshimet dhe nga vetë grupi i punës mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis;

*duke vënë në dukje* Konventën për të drejtën për informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për çështje që lidhen me mjedisin, bërë në Aarhus, Danimarkë, më 25 qershor 1998, dhe duke mbajtur parasysh Protokollin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, bërë në Kiev, Ukrainë, më 21 maj 2003;

*gjithashtu duke vënë në dukje* instrumentet ligjore përkatëse të Komunitetit Europian, si direktiva 85/337/EEC e 27 qershorit 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin, të ndryshuar nga direktiva 97/11/EC dhe 2003/35/EC;

*e ndërgjegjshme* që një zgjerim i shtojcës I do të forcojë në rajon rëndësinë e vlerësimeve të ndikimit në mjedis;

*duke njohur* përfitimet e bashkëpunimit ndërkombëtar sa më shpejt të jetë e mundur në vlerësimin e ndikimit në mjedis;

duke inkurajuar punën e Komitetit Zbatues si një mjet i dobishëm për zbatimin e mëtejshëm dhe aplikimin e dispozitave të Konventës:

1. Konfirmon që vlefshmëria e vendimeve të marra para hyrjes në fuqi të amendamentit të dytë të Konventës, duke përfshirë adoptimin e protokolleve, krijimin e organizmave mbështetës, rishikimin e përshtatshmërisë dhe veprimeve të marra nga Komiteti Zbatues, nuk ndikohen nga adoptimi dhe hyrja në fuqi e këtij amendamenti.

2. Gjithashtu konfirmon që secila palë vazhdon të jetë e përshtatshme të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet në bazë të Konventës, duke përfshirë përgatitjen e protokolleve, krijimin dhe pjesëmarrjen në organizmat mbështetës, dhe shqyrtimin e respektimit, pavarësisht nëse amendamenti i dytë i Konventës ka hyrë në fuqi apo jo për atë palë.

3. Adopton amendamentet e mëposhtme të Konventës:

a) Në nenin 2, pas paragrafit 10, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

11. Nëse pala iniciatore synon të kryejë një procedurë me qëllimin e caktimit të përmbajtjes së dokumentacionit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, palës së interesuar, në masën e duhur, duhet t'i krijohet mundësia për të marrë pjesë në këtë procedurë.

b) Në nenin 8, pas Konventës futet

dhe në bazë të çdo protokollit të saj në të cilin ato janë palë.

c) Në nenin 11, zëvendësohet paragrafi 2(c) nga një nënparagraf i ri me këtë formulim:

c) Kërkojnë, sipas rastit, shërbimet dhe bashkëpunimin e organeve kompetente që kanë ekspertizën që lidhet me arritjen e qëllimeve të kësaj Konvente;

d) Në fund të nenit 11, futen dy nënparagrafë me këtë formulim:

g) Përgatisin, sipas rastit, protokollet e kësaj Konvente;

h) Krijojnë organizma të tillë mbështetës që konsiderohen të nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.

e) Në nenin 14 paragrafi 4 zëvendësohet fjalia e dytë me një fjali të re me këtë formulim:

Ato hyjnë në fuqi për palët që i kanë ratifikuar, miratuar ose pranuar ato në ditën e nëntëdhjetë pas marrjes nga depozituesi të njoftimit për ratifikimin, pranimin ose miratimin e tyre nga të paktën tre të katërtat e numrit të palëve në kohën e adoptimit të tyre.

f) Pas nenit 14, futet një nen i ri me këtë formulim:

Neni 14 bis

### **Shqyrtimi i respektimit**

1. Palët rishikojnë respektimin e dispozitave të kësaj Konvente në bazë të procedurës së respektimit, si një procedurë joakuzatore dhe e orientuar drejt ndihmesës, e miratuar nga mbledhja e palëve. Shqyrtimi bazohet mbi, por nuk kufizohet nga raportimi i rregullt nga ana e palëve. Mbledhja e palëve vendos mbi shpeshësinë e raportimit të rregullt të kërkuar nga palët dhe informacionin që duhet të përfshihet në ato raporte të rregullta.

2. Procedura e respektimit duhet të jetë e përshtatshme për zbatimin e çdo protokollit të adoptuar në bazë të kësaj Konvente.

g) Zëvendësohet shtojca I e Konventës nga shtojca e këtij vendimi.

h) Në shtojcën VI, pas paragrafit 2, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

3. Paragrafët 1 dhe 2 mund të zbatohen, *mutatis mutandis* për çdo protokoll të Konventës.

### **SHTOJCA**

#### **LISTA E AKTIVITETEVE**

1. Rafineri të naftës bruto (duke përjashtuar sipërmarrje për prodhimin e lubrifikanteve nga nafta bruto) dhe instalime për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 tonëve metrikë ose më tepër qymyr ose rërë bituminoze në ditë.

2. a) Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies me prodhim nxehtësie prej 300 megawat ose më shumë, dhe

b) Stacione bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë duke përfshirë çmontimin dhe heqjen nga funksionimi të këtyre stacioneve dhe reaktorëve bërthamorë 1 (duke përjashtuar impiantet kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e materialeve të ndashme ose ushqyese, fuqia maksimale e të cilëve nuk i kalon 1 kilowat ngarkesë termike të vazhdueshme).

3. a) Instalime për ripërpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar.  
 b) Instalime të projektuara:
  - Për prodhimin dhe pasurimin e karburantit bërthamor;
  - Për përpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiviteti;
  - Për depozitimin përfundimtar të karburantit bërthamor të rrezatuar;
  - Vetëm për depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive;
  - Vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më shumë se 10 vjet) të karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjes radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.
4. Instalime të mëdha për shkrirjen fillestare të gizës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve pa përmbajtje hekuri.
5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e asbest-çimentos, me një prodhim vjetor prej më shumë se 20 000 tonë metrikë produkt përfundimtar; për materiale fërkimi, me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 tonë metrikë produkt përfundimtar dhe për përdorimin e llojeve të tjera të asbestit për më shumë se 200 tonë metrikë në vit.
6. Instalime kimike të integruara.
- 7.a) Ndërtimi i autostradave, rrugëve të shpejtësisë 2/ dhe linjave të distancave të gjata të trafikut hekurudhor dhe të aeroporteve 3/ me pistë bazë (ngritje-ulje) prej 2100 metra ose më tepër.  
 b) Ndërtimi i një rruge të re me katër korsi ose më shumë, ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese me dy ose më pak korsi për të siguruar katër ose më shumë korsi ku kjo rrugë e re ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i seksionit të rrugës do të jetë 10 km ose më shumë në gjatësi të vazhduar.
8. Tubacionet me diametër të madh për transportimin e naftës, gazit ose kimikateve.
9. Portet tregtare dhe gjithashtu rrugët ujore të brendshme dhe portet për trafikun ujor të brendshëm që lejojnë kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 tonë metrikë.
10. a) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie, trajtim kimik ose groposje për mbetje toksike dhe të rrezikshme.  
 b) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie ose trajtim kimik të mbetjeve të parrezikshme me kapacitet mbi 100 ton metrikë në ditë.
11. Diga dhe rezervuarë të mëdhenj.
12. Aktivitetet e nxjerrjes së ujërave nëntokësore ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësore, ku vëllimi vjetor i sasive të ujërave të nxjerra ose të ringarkuara është 10 milionë m<sup>3</sup> ose më shumë.
13. Prodhimi i letrës, brumit të letrës dhe kartonit me kapacitet 200 tonë metrikë në ditë ose më shumë, i tharë me ajër.
14. Miniera dhe kariera (gurore) të mëdha, nxjerrja dhe përpunimi në vend i mineraleve metalike ose qymyrit.
15. Prodhimi i hidrokarbureve në det. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare ku sasia e nxjerrë kalon 500 tonë metrikë në ditë në rastin e naftës dhe 500 000 m<sup>3</sup> në ditë në rastin e gazit.
16. Impiante të mëdha për ruajtjen e naftës, produkteve petrokimike dhe kimike.
17. Shpyllëzimi i zonave të mëdha.
18. a) Punime për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve të lumenjve, ku transferimi synon parandalimin e pakësimit të ujërave, dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 100 milionë m<sup>3</sup> në vit;  
 b) Në të gjitha rastet e tjera, punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve ku rrjedha shumëvjeçare e basenit është më e madhe se 2000 milionë m<sup>3</sup> në vit dhe ku sasia e ujit të transferuar është më e madhe se 5 për qind e kësaj rrjedhjeje. Në të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm me tubacione.
19. Impiante për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet që e kalon ekuivalentin e një popullsie 150 000 banorë.

20. Instalimet për rritjen intensive të shpendëve dhe derrave që kanë më shumë se:
- a) 85 000 vende për zogj;
  - b) 60 000 vende për pula;
  - c) 3000 vende për derra (mbi 30 kg);
  - d) 900 vende për dosa.
21. Ndërtimi i linjave ajrore të tensionit të lartë me një tension 220 kV ose më shumë dhe një gjatësi prej më shumë se 15 km.
22. Instalime të mëdha për shfrytëzimin e kombinuar të fuqisë së erës për prodhim energjie (fermat e erës).
1. Për qëllimet e kësaj Konvente, stacionet e fuqisë bërthamore dhe reaktorët e tjerë bërthamorë pushojnë së qeni instalime të tilla kur gjithë karburanti bërthamor dhe elementet e tjera të ndotura radioaktive janë zhvendosur përfundimisht nga vendi i instalimit.
2. Për qëllime të kësaj Konvente:
- “Autostradë” është një rrugë e projektuar dhe e ndërtuar për trafik automobilistik, e cila nuk u shërben zonave përreth, dhe e cila:
- a) Është e pajisur, me përjashtim të pikave të veçanta ose përkohësisht, me karrexhata të ndara për të dy drejtimet e trafikut, të ndara nga njëra-tjetra nga një vijë ndarëse që nuk shkelet nga trafiku, ose në raste të rralla, me mjete të tjera;
  - b) Nuk ndërpritet në të njëjtin nivel nga ndonjë rrugë, shinë hekurudhe ose tramvaji apo rrugë këmbësorësh;
  - c) Është e sinjalizuar në mënyrë të veçantë si autostradë.
- “Rrugë shpejtësie” është një rrugë e rezervuar për trafik makinash ku hyrja mund të bëhet vetëm nga kryqëzimet në disnivel ose kryqëzimet e kontrolluara dhe në të cilën veçanërisht ndalimi dhe parkimi janë të ndaluara përgjatë karrexhatave të lëvizjes.
3. Për qëllime të kësaj Konvente, “aeroport” do të thotë një aeroport që është në pajtim me përkufizimin e Konventës së (Çikagos të vitit 1944 për krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (aneksi 14).
- Vërtetohet se teksti i mësipërm është një kopje origjinale e amendamentit të miratuar më 4 qershor 2004 në mbledhjen e tretë të palëve në Konventën mbi vlerësimin e ndikimit në ambient në një kontekst ndërkufitar, që u mbajt në Cavtat, Kroaci, nga data 1 deri 4 qershor 2004.

Për Sekretarin e Përgjithshëm  
Këshilltari Ligjor  
(Nënshektarin e Përgjithshëm për Çështjet Ligjore)

Organizata e Kombeve të Bashkuara, New York  
10 nëntor 2004

## VENDIMI II/14 AMENDAMENTI I KONVENTËS SË ESPOO-S

Mbledhja,  
*me dëshirën* për të ndryshuar Konventën ESPOO me qëllim që të sqarohet që publiku që mund të marrë pjesë në procedura, në bazë të kësaj Konvente, përfshin shoqërinë civile dhe veçanërisht organizatat joqeveritare;  
*duke vënë* në dukje paragrafin 13 të Deklaratës së Oslos të ministrave të ambientit dhe

komisionerit të Komunitetit Europian për ambientin të mbledhur në Oslo me rastin e mbledhjes së parë të palëve në Konventën ESPOO;

*me dëshirën* për të lejuar shtetet që ndodhen jashtë rajonit UN/ECE të bëhen palë në Konventë,

adopton amendamentet e mëposhtme të Konventës:

a) Në fund të nenit 1(x) pas personave futet

dhe në pajtim me legjislacionin ose praktikën e brendshme, shoqatat, organizatat ose grupet e tyre.

b) Në nenin 17, pas paragrafit 2, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

3. Çdo shtet tjetër që nuk është përmendur në paragrafin 2 të këtij neni dhe që është anëtar i Kombeve të Bashkuara mund të aderojë në Konventë me miratimin e mbledhjes së palëve. Mbledhja e palëve nuk merr në shqyrtim apo aprovon asnjë kërkesë për aderim nga një shtet i tillë, derisa ky paragraf nuk ka hyrë në fuqi për të gjitha shtetet dhe organizatat që ishin palë në Konventë më 27 shkurt 2001.

Dhe numrat e paragrafëve të tjerë ndryshohen përkatësisht.

c) Në fund të nenit 17, futet një paragraf i ri me këtë formulim:

7. Çdo shtet apo organizatë që ratifikon, pranon ose aprovon këtë Konventë konsiderohet të ketë ratifikuar, pranuar apo aprovuar njëkohësisht amendamentin e Konventës, të caktuar në vendimin II/14 të marrë në mbledhjen e dytë të palëve.

## **L I G J**

**Nr.9479, datë 16.2.2006**

### **PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR MBROJTJEN E PËRBASHKËT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I**

### **I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

## **V E N D O S I:**

### **Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen e përbashkët të informacionit të klasifikuar”.

### **Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4801, datë 10.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

## **MARRËVESHJE**

### **NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË MAQEDONISË PËR MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, (këtu referuar si “Palët”);

që kanë për qëllim të sigurojnë mbrojtjen e ndërsjellë të të gjithë informacionit të klasifikuar, në shtetin e njëjës Palë dhe të transferuar në shtetin e Palës tjetër,

*duke dëshiruar* të vendosin rregulla për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar,

që do të shtrihen në të gjitha marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet Palëve dhe në kontratat e vendosura ndërmjet organizatave të Shteteve Palë, të cilat sigurojnë shkëmbimin e informacionit të klasifikuar,

janë marrë vesh për sa më poshtë:

#### Neni 1

#### **Përkufizime**

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Informacion i klasifikuar” nënkupton çdo informacion, i cili kërkon mbrojtje ndaj aksesit ose përdorimit të paautorizuar, të përcaktuar si të tillë nëpërmjet një klasifikimi sigurie.

2. “Palë marrëse” nënkupton Palën në këtë Marrëveshje, në të cilën transmetohet informacioni/materiali i klasifikuar.

3. “Pala e origjinës” nënkupton Palën në këtë Marrëveshje që e dërgon informacionin/materialin e klasifikuar.

4. “Autoriteti kompetent i sigurisë” nënkupton autoritetin, i cili, në përputhje me rregullat dhe ligjet kombëtare, përgjigjet për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

5. “Kontraktues” nënkupton një individ apo një person juridik që ka kapacitetin ligjor për të lidhur kontrata.

6. “Kontratë e klasifikuar” nënkupton një marrëveshje ndërmjet dy apo më shumë subjektsh administrative, individëve apo subjekteve ligjore që krijon dhe përcakton të drejta dhe detyrime të detyrueshme ndërmjet tyre, e cila përmban apo përfshin informacion të klasifikuar.

7. “Palë e tretë” nënkupton një organizatë ndërkombëtare apo shtet të tretë që nuk është Palë e kësaj Marrëveshjeje.

8. “Vizitorë” nënkupton përfaqësues zyrtarë të një Pale që kërkojnë të vizitojnë ambientet e Palës tjetër në këtë Marrëveshje që janë të angazhuara në veprimtari që përfshijnë materiale dhe/ose informacion të klasifikuar.

9. “Certifikatë sigurie personeli” nënkupton dokumentin që lëshohet nga autoriteti kompetent i sigurisë për një qytetar të një Pale për akses në materialin dhe/ose informacionin e klasifikuar, në përputhje me rregulloret dhe ligjet respektive të sigurisë kombëtare.

10. “Certifikatë sigurie pajisjeje” nënkupton dokumentin që lëshohet nga autoriteti kompetent i sigurisë dhe që provon se një kompani ose institucion ka aftësinë organizative dhe fizike të përdorë dhe të depozitojë material dhe/ose informacion të klasifikuar, në përputhje me rregulloret dhe ligjet respektive të sigurisë kombëtare.

#### Neni 2

#### **Nivelet e klasifikimit të sigurisë**

Nivelet e klasifikimit të sigurisë dhe ekuivalentet e Palëve janë:

| Në Republikën e Shqipërisë | Në Republikën e Maqedonisë | Ekuivalenti në anglisht |
|----------------------------|----------------------------|-------------------------|
| Tepër sekret               | Drzavna Tajna              | Top secret              |
| Sekret                     | Strogo Doverlivo           | Secret                  |
| Konfidencial               | Doverlivo                  | Confidential            |
| -----                      | Interno                    | Restricted              |

#### Neni 3

#### **Autoritetet kompetente të sigurisë**

1. Autoritetet kompetente të sigurisë së Shteteve Palë, që përgjigjen për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, janë si më poshtë:

Për Republikën e Shqipërisë: Drejtoria për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar (Autoriteti i Sigurisë Kombëtare).

Për Republikën e Maqedonisë: Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

2. Autoritetet kompetente të sigurisë do t’i sigurojnë njëri-tjetrit kredencialet e tyre zyrtare.

3. Me qëllim që të arrihen dhe të mbahen standarde të krahasueshme sigurimi, autoritetet kompetente respektive të sigurimit, sipas kërkesës, i sigurojnë njëri-tjetrit informacion rreth

procedurave, praktikave dhe standardeve të sigurimit për ruajtjen e informacionit të klasifikuar në Palën tjetër respektive.

#### Neni 4

##### **Aksesi tek informacioni i klasifikuar**

1. Aksesi tek informacioni i klasifikuar do të jetë për ata persona që kanë nevojë për njohje dhe që janë certifikuar nga autoriteti kompetent i sigurisë, në përputhje me rregullat dhe ligjet kombëtare të shteteve, që korrespondojnë me nivelin e kërkuar të klasifikimit të sigurisë së informacionit që është për njohje.

2. Pala Marrëse:

a) nuk do t'i japë informacion të klasifikuar një Pale të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës së Origjinës;

b) do t'i sigurojë informacionit të klasifikuar një nivel klasifikimi sigurie ekuivalent me atë të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në vazhdimësi do t'i sigurojë një mbrojtje ekuivalente me atë të nivelit korrespondues të klasifikimit të siguruar nga Pala e Origjinës;

c) nuk do ta përdorë informacionin e klasifikuar për qëllime të tjera, përveç atij për të cilin ai është siguruar.

#### Neni 5

##### **Transmetimi i informacionit të klasifikuar**

1. Informacioni i klasifikuar do të transmetohet normalisht përmes shërbimit diplomatik, ushtarak dhe korrier, të miratuar nga autoriteti kompetent i sigurisë. Pala Marrëse do të konfirmojë marrjen e informacionit të klasifikuar.

2. Në qoftë se do të transmetohet një pako e madhe që përmban informacion të klasifikuar, autoriteti kompetent respektiv duhet të jetë dakord dhe të miratojë mjetet e transmetimit, rrugën dhe masat e sigurimit për çdo rast të tillë.

3. Mjete të tjera të miratuara të transmetimit apo shkëmbimit të informacionit të klasifikuar, përfshirë mjetet elektromagnetike, mund të përdoren në qoftë se miratohet nga autoritetet kompetente.

#### Neni 6

##### **Shenjëzimi i informacionit të klasifikuar**

1. Pala Marrëse do të ruajë nivelin e klasifikimit të origjinalit dhe do të shenjëzojë informacionin e klasifikuar të marrë sipas shenjëzimit të klasifikimit të sigurisë korrespondues, të përcaktuar në nenin 2 më sipër.

2. Kopjet dhe përkthimet e informacionit të klasifikuar të marrë, do të shenjëzohen dhe ruhen në të njëjtën mënyrë si origjinali.

3. Kërkesat e shenjëzimit do të zbatohen gjithashtu për informacionin e klasifikuar të marrë mbështetur në një kontratë të klasifikuar.

#### Neni 7

##### **Shkatërrimi**

1. Informacioni i klasifikuar do të shkatërrohet në mënyrë të tillë që të shmanget rindërtimi i pjesshëm apo i plotë i tij.

2. Informacioni dhe materialet Tepër Sekret/Drzavna Tajna/Top Secret nuk do të shkatërrohen. Ato do të kthehen tek autoriteti respektiv kompetent i sigurisë së Palës së Origjinës.

#### Neni 8

##### **Riprodhimi dhe përkthimi i dokumenteve të klasifikuara**

1. Dokumentet e klasifikuara që përmbajnë informacion Tepër Sekret/Drzavna Tajna/Top Secret do të lejohen të përkthehen dhe fotokopjohen vetëm me lejen me shkrim të autoritetit kompetent të sigurisë së Palës së Origjinës.

2. Të gjitha kopjet e riprodhuara të dokumenteve të klasifikuara do të shenjëzohen me të njëjtin shenjëzim të origjinalit. Ky informacion i riprodhuar do të mbrohet si informacioni origjinal. Numri i kopjeve do të kufizohet në numrin e domosdoshëm për qëllimin zyrtar.

3. Të gjitha përkthimet e informacionit të klasifikuar do të bëhen nga persona të certifikuar me nivel të njëjtë me informacionin e klasifikuar. Përkthimi do të shenjëzohet me të njëjtin shenjëzim të origjinalit dhe do të ketë një shënim në gjuhën në të cilën është përkthyer se përkthimi përmban informacion të klasifikuar të Palës së Origjinës.

#### Neni 9

##### **Vizitat**

1. Ekspertët e sigurisë së Autoriteteve Kompetente të Sigurisë mund të vizitojnë periodikisht njëri-tjetrin, me qëllim që të diskutojnë procedurat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

2. Miratimi paraprak i Autoritetit Kompetent të Sigurisë së Palës pritëse do të kërkohej në lidhje me vizitorët, në qoftë se aksesit tek informacioni i klasifikuar apo të mjedisit ku informacioni i klasifikuar zhvillohet, ruhet apo magazinohet, është i nevojshëm.

3. Procedurat që lidhen me vizitat do të zhvillohen dhe miratohen ndërmjet Autoriteteve Kompetente të Sigurisë.

4. Çdo Palë do të garantojë mbrojtjen e të dhënave personale të vizitorëve sipas rregullave dhe ligjeve kombëtare respektive.

#### Neni 10

##### **Kontratat e klasifikuara**

1. Në qoftë se lidhet një kontratë e klasifikuar ndërmjet kontraktorëve të Palëve të kësaj Marrëveshjeje, do të sigurohet më parë një garanci nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë në mënyrë që kontraktori i propozuar të ketë një certifikatë sigurie që përputhet me nivelin e klasifikimit të sigurisë së kërkuar dhe që ka zbatuar marrëveshje të përshtatshme sigurie për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

Kjo garanci, gjithashtu, përfshin detyrimin për të siguruar që rregullat e sigurisë së kontraktorit të certifikuar të korrespondojnë me legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar dhe që këto rregulla mbikëqyren nga Autoriteti Kompetent i Sigurisë.

2. Autoriteti Kompetent i Sigurisë përgjigjet për të siguruar që çdo pjesë e informacionit të klasifikuar, i cili i është dhënë kontraktorit të Palës tjetër apo është prodhuar në lidhje me një kontratë të klasifikuar, ka të përcaktuar klasifikimin e sigurisë. Me kërkesë të Autoritetit Kompetent të Sigurisë së kontraktorit, Autoriteti Kompetent i Sigurisë së Palës tjetër do të sigurojë një listë kërkesash sigurie. Gjithashtu, Autoriteti Kompetent i Sigurisë së Palës tjetër do të sigurojë Autoritetin Kompetent të Sigurisë së kontraktorit me një deklaratë njoftimi se kontraktori ka marrë përsipër të respektojë legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar. Autoriteti Kompetent i Sigurisë i Palës tjetër do të dorëzojë tek Autoriteti Kompetent i Sigurisë së kontraktorit njoftimin përkatës të detyrimit të kontraktorit për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

3. Autoriteti Kompetent i Sigurisë së kontraktorit do të konfirmojë me shkrim marrjen e listës së kërkesave të kërkuara të sigurisë dhe do t'ia çojë këtë listë kontraktorit.

4. Në çdo rast, Autoriteti Kompetent i Sigurisë së kontraktorit do të sigurojë që kontraktori do të trajtojë pjesë të caktuara të një kontrate, të cilat kërkojnë klasifikim, në të njëjtën mënyrë si informacioni i klasifikuar i shtetit të kontraktorit në përputhje me nivelin e klasifikimit të fiksuar në listën e kërkesave të sigurisë.

5. Nëse Autoriteti Kompetent i Sigurisë miraton një nënkontratë të klasifikuar, do të veprojë në përputhje me paragrafin 2 dhe 4 të këtij neni.

6. Palët do të sigurojnë që një kontratë e klasifikuar është lidhur apo eventualisht, puna në pjesët e klasifikuara fillon vetëm pasi kontraktori ka zbatuar masat e sigurimit.

#### Neni 11

##### **Shkeljet e sigurisë**

1. Në rast se një shkelje e rregullave të sigurimit rezulton në kompromentimin e sigurt apo të dyshuar të informacionit të klasifikuar të marrë nga Pala tjetër, Autoriteti Kompetent i Sigurisë i shtetit ku ndodhi kompromentimi do të informojë Autoritetin Kompetent të Sigurisë së Palës tjetër sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të bëjë hetimet përkatëse. Pala tjetër, nëse kërkohet, do të bashkëpunojë për hetimin.

2. Në rast se kompromentimi ndodh në një shtet tjetër jo palë, Autoriteti Kompetent i Sigurisë së Palës dërguese do të ndërmarrë veprimet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Pala tjetër do të informohet për rezultatet e hetimit dhe do t'i sigurohet një raport përfundimtar si për arsyet e ngjarjes ashtu edhe për shkallën e dëmtimit.

## **Neni 12 Shpenzimet**

Çdo Palë do të mbulojë vetë shpenzimet që do të bëjë ajo vetë në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

## **Neni 13 Dispozitat e fundit**

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, nëpërmjet të cilit Palët informojnë njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike që kërkesat e legjislacionit kombëtar për hyrjen e saj në fuqi janë plotësuar.

2. Kjo Marrëveshje është përfunduar për një periudhë të pakufizuar kohe. Ajo mund të përfundojë nga një Palë duke i dërguar Palës tjetër një njoftim me shkrim për përfundimin e saj. Përfundimi do të hyjë në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së njoftimit për përfundim.

3. Pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, i gjithë informacioni i klasifikuar i siguruar gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të vazhdojë të mbrohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, derisa Pala e Origjinës të përjashtojë Palën Marrëse nga ky detyrim.

4. Çdo Palë do të njoftojë Palën tjetër për ndonjë ndryshim të rregulloreve dhe ligjeve të saj që mund të ndikojnë në mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas kësaj Marrëveshjeje. Në një rast të tillë, Palët do të konsultohen për ndryshimet e mundshme të kësaj Marrëveshjeje. Ndërkohë, informacioni i klasifikuar do të vazhdojë të ruhet siç është përshkruar këtu, përderisa nuk është kërkuar ndryshe me shkrim nga Pala e Origjinës.

5. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të miratimit të shkruar të të dyja Palëve. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurat për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

6. Ndonjë mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me konsultim ndërmjet Palëve pa iu drejtuar juridiksionit të jashtëm.

7. Aspektet të tjera teknike të bashkëpunimit mund të ndryshohen me pëlqimin reciprok të Palëve.

Bërë në Tiranë, më 16 nëntor 2005, në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip, maqedonisht dhe anglisht, të gjitha tekstet njësoj autentike. Në rast mosmarrëveshjes në interpretimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

## **L I G J Nr.9483, datë 16.2.2006**

### **PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror sha (ANTA) përjashtohet nga pagimi i tatimit në burim për të ardhurat nga shërbimet navigacionale ajrore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.4803, datë 10.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu**

**DEKRET**

**Nr.4805, datë 15.3.2006**

**PËR EMËRIM AMBASADORI**

Në mbështetje të neneve 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Adrian Neritani, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përhershëm të Republikës së Shqipërisë në New-York.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Alfred Moisiu**

**VENDIM**

**Nr.134, datë 8.3.2006**

**PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,  
PARAUNIVERSITAR, SI SHKOLLË E MESME E PËRGJITHSHME, E PROFILIZUAR  
“MEMORIAL INTERNATIONAL SCHOOL”, QË DO TA ZHVILLOJË MËSIMIN EDHE NË  
GJUHËN ANGLEZE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e lejes për hapjen, në qytetin e Tiranës, të institucionit arsimor privat, parauniversitar, si shkollë e mesme e përgjithshme, e profilizuar “Memorial International School”, që do ta zhvillojë mësimin edhe në gjuhën angleze.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**  
**Nr.135, datë 8.3.2006**

**PËR PROCEDURAT DHE ÇMIMET E DHËNIES ME QIRA TË SIPËRFAQEVE UJORE,  
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AKUAKULTURËS INTENSIVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënien me qira të sipërfaqeve ujore në zonat detare, në ujërat e brendshme (pa përfshirë ujëmbledhësit e bujqësisë, që shërbejnë për ujitje) dhe në liqenet natyrore, për ushtrimin e veprimtarive të akuakulturës intensive.

2. Sipërfaqet ujore u jepen me qira personave juridikë e fizikë, vendas apo të huaj, që janë pajisur me licencë peshkimi dhe me leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në përputhje me planet e integruara të zhvillimit të zonës (bregdetare apo liqenore).

3. Kontrata e dhënies me qira të sipërfaqes ujore lidhet në datën efektive të dhënies së licencës, në të cilën përcaktohet qartë edhe sipërfaqja ujore, që jepet në përdorim për veprimtarinë e miratuar.

4. Subjekti lidh kontratë qiraje me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

5. Afati i kontratës për dhënien me qira të sipërfaqes ujore është i njëjtë me kohëzgjatjen e licencës. Subjektet e pajisura me licencë, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi janë të detyruara të lidhin kontratën e qirasë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dhe vlefshmëria e kontratës do të jetë deri në mbarimin e afatit të përcaktuar në licencë.

6. Për kategoritë ujore, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, zbatohen çmimet e qirasë vjetore, si më poshtë vijojnë:

I. Për të gjitha kategoritë ujore deri në 1 ha 20 000 lekë.

II. Për sipërfaqet ujore mbi 1 ha:

a) Për zonat detare 2.1 lekë m<sup>2</sup>/vit;

b) Për zonat e ujërave të brendshme 2 lekë m<sup>2</sup>/vit;

c) Për liqenet e Ohrit, të Shkodrës, Prespës së Madhe e asaj të Vogël dhe të Butrintit 5 lekë m<sup>2</sup>/vit.

7. Për vitin e parë vlera e qirasë paguhet në çastin e nënshkrimit të kontratës, ndërsa për vitet pasardhëse paguhet në datën e vendosur në kontratë, e cila parashikon edhe penalitetet për shkelje të afatit të pagesës.

8. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka të drejtë ta prishë kontratën përpara mbarimit të saj kur, për shkak të ndryshimit të cilësisë së ujërave nga veprimtaria e akuakulturës, subjektit i hiqet leja mjedisore.

9. Të ardhurat e siguruar nga dhënia me qira e sipërfaqeve ujore administrohen sipas shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.

10. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**  
**Nr.137, datë 8.3.2006**

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA E VEÇANTË E SHKOLLIMIT, NË KUOTAT DYTËSORE, PËR SISTEMIN ME KOHË TË PLOTË, TË STUDENTËVE, QË JANË TË VERBËR, INVALIDË PARAPLEGJIKË DHE TETRAPLEGJIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, 31 e 42 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Studentët që janë të verbër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, sipas fakulteteve dhe degëve përkatëse, të cilët përfitojnë nga kuotat dytësore, të përjashtohen nga tarifa e veçantë e shkollimit, e përcaktuar në pikën 2.b të vendimit nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kuotave të pranimeve në universitetet dhe shkollat e larta, për vitin akademik 2005-2006, në sistemin me kohë të plotë, si dhe përcaktimin e tarifave të shkollimit për këtë vit akademik”, të ndryshuar.

2. Tarifa e shkollimit, e përcaktuar për këtë kuotë pranimi, për studentët që janë të verbër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët janë regjistruar me kuotë dytësore, në fakultete dhe degë të ndryshme të shkollave të larta, të reduktohet në masën e kuotës kryesore, prej 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekësh, sipas pikës 8 të vendimit nr.560, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.143, datë 8.3.2006**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS, PËR HEQJEN E NDËRSJELLË TË VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e Marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë të Spanjës, për heqjen e ndërsjellë të vizave për pasaportat diplomatike dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**MARRËVESHJE**  
**NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË TË SPANJËS, MBI HEQJEN RECIPROKE TË VIZAVA PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Mbretërisë së Spanjës (më poshtë të quajtura “Palë Kontraktuese”),  
të vendosura për zhvillimin e marrëdhënieve të miqësisë dhe bashkëpunimit,  
me dëshirën për të lehtësuar udhëtimet zyrtare të mbajtësve të pasaportave diplomatike apo të shërbimit ndërmjet dy shteteve,  
ranë dakord si më poshtë:

#### Neni 1

Shtetasit e Mbretërisë së Spanjës, mbajtës të pasaportave spanjolle në fuqi, diplomatike apo të shërbimit, mund të hyjnë pa viza në territorin e Republikës së Shqipërisë për një kohë qëndrimi deri në 90 ditë (tre muaj) gjatë një periudhe prej 180 ditësh (gjashtë muaj), me kusht që gjatë qëndrimit të tyre të mos angazhohen në veprimtari fitimprurëse, përveç atyre që kryhen për qëllime të akreditimit.

#### Neni 2

Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, mbajtës të pasaportave shqiptare në fuqi, diplomatike apo të shërbimit, mund të hyjnë në territorin e Spanjës pa viza për një kohë qëndrimi deri në 90 ditë (tre muaj) gjatë një periudhe prej 180 ditësh (gjashtë muaj), me kusht që gjatë qëndrimit të tyre të mos angazhohen në veprimtari fitimprurëse, përveç atyre që kryhen për qëllime të akreditimit.

Kur ata hyjnë në territorin e Mbretërisë së Spanjës, pas kalimit transit në territorin e njërit apo më shumë vendeve për të cilët aplikohen plotësisht dispozitat në lidhje me eliminimin e kontrollit të brendshëm të kufijve dhe kufizimeve të lëvizjeve të personave, siç është parashikuar në pjesën e dytë të Konventës për zbatimin e Marrëveshjes së Schengen-it, të datës 19 qershor 1990, tre muaj do të llogariten duke filluar nga data e kalimit të kufirit të jashtëm që përcakton zonën e lëvizjes së lirë të krijuar nga shtetet e sipërpërmendura.

#### Neni 3

Dispozitat e mësipërme nuk i përjashtojnë përfituesit e tyre nga detyrimi për të respektuar legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe me Mbretërinë e Spanjës, respektivisht pa paragjykuar privilegjet dhe imunitetet e garantuara nga konventat ndërkombëtare, të cilat janë të detyrueshme për Palët Kontraktuese.

#### Neni 4

Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Spanjës do të shkëmbejnë ekzemplarët e pasaportave respektive diplomatike dhe të shërbimit në fuqi nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Ministritë e sipërpërmendura do të informojnë menjëherë dhe në mënyrë të përshtatshme njëra-tjetrën për çdo ndryshim të bërë në legjislacionet e tyre për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit, si edhe për ndonjë ndryshim në formatin e tyre, gjë për të cilën duhet t'i dorëzojnë palës tjetër ekzemplarë të rinj.

#### Neni 5

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e përbashkët ndërmjet Palëve Kontraktuese nëpërmjet shkëmbimit të notave. Ndryshimet do të hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e vendosur në paragrafin 2 të nenit 8.

#### Neni 6

Secila nga Palët Kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht apo pjesërisht, për një kohë të përcaktuar, për arsye të sigurisë së shtetit, të rendit publik apo shëndetit publik. Marrja apo anulimi i një mase të tillë do të komunikohet sa më shpejt të jetë e mundur nëpërmjet rrugëve diplomatike. Një pezullim i tillë do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë, pasi Pala

tjetër Kontraktuese të ketë marrë njoftimin.

#### Neni 7

Secila nga Palët Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje, nëpërmjet njoftimit me shkrim përmes rrugëve diplomatike. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga Pala tjetër.

#### Neni 8

1. Kjo Marrëveshje përfundohet për një kohë të pacaktuar.  
2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet përkohësisht, pasi të kenë kaluar tridhjetë ditë nga data e nënshkrimit të saj dhe do të hyjë në fuqi ditën e fundit të muajit pasardhës të komunikimit të fundit në rrugë diplomatike midis Palëve Kontraktuese, për njoftimin mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore të brendshme për hyrjen në fuqi.

Në dëshmi të kësaj, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve Kontraktuese nënshkruajnë këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 6 shkurt 2006, në 2 kopje origjinale, në gjuhët shqip dhe spanjisht, duke qenë të dy tekstet autentike të barabarta.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë  
Ministri i Punëve të Jashtme  
Besnik Mustafaj

Për Qeverinë e Mbretërisë së Spanjës  
Ministri i Punëve të Jashtme dhe i Bashkëpunimit  
Miguel Angel Moratinos Cuyaube

#### VENDIM

**Nr.144, datë 8.3.2006**

#### **PËR BOTIMIN, SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE, TË SISTEMIT ARSIMOR PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9,56 e 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës miraton tekste shkollore alternative për arsimin parauniversitar, të cilat konkurrojnë në kushtet e barazisë së plotë, me përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat për këtë proces përcaktohen me udhëzim të Ministrit.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës nuk ushtron më funksione botimi, shtypjeje dhe shpërndarjeje të librit shkollor, si dhe nuk përdor fonde për subvencion të drejtpërdrejtë në procesin e prodhimit të teksteve shkollore.

3. Procesi i botimit, shtypjes dhe shpërndarjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar do të bëhen nga shtëpitë botuese.

4. Vlerat e përcaktuara si subvencion nuk do të përdoren drejtpërdrejt për uljen e çmimeve të teksteve, por do të përdoren nga përdoruesi, për të përballuar diferencën e çmimit të shitjes.

5. Në rastet e subvencionimit të teksteve shkollore, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, fondet e miratuara për këtë qëllim, i kalon në përdorim të drejtpërdrejtë të shkollës/përdoruesit.

6. Për shkollat e arsimit bazë dhe shkollat e mesme, në qendër bashkie a komune ose, sipas rastit, për çdo shkollë ose grup shkollash, të çelen numra llogarie pranë degëve të thesarit në rrethe.

7. Për të gjitha shkollat e tjera, 9-vjeçare dhe të mesme, që nuk ndodhen në qendër bashkie a komune, si dhe shkollat e tjera, që nuk kanë standardet dhe infrastrukturën e nevojshme për t’iu mundësuar çelja e llogarive buxhetore, ky proces do të realizohet përmes llogarisë buxhetore të zyrës arsimore në rreth.

8. Masat e subvencionit do të likuidohen nga përdoruesi, në llogarinë e shtëpisë botuese, pas

dorëzimit të teksteve të porositura.

9. Procedurat e përdorimit të fondeve buxhetore, të miratuara për subvencion, për blerjen e teksteve shkollore, përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe Ministrit të Financave.

10. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

11. Pika 1 e vendimit nr.136, datë 7.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar” dhe pika 1 e vendimit nr.237, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2004-2005”, si dhe të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.145, datë 8.3.2006**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.388, DATË 31.5.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRAT E KOMISIONIT SHTETËROR TË PRODHIMIT ORGANIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3 të ligjit nr.9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve “BIO””, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.388, datë 31.5.2005 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Komisioni Shtetëror i Prodhimit Organik (KSHPO), i cili krijohet si organ ndërinstitutional, të ketë në përbërje 9 veta, konkretisht:

- |                                                                                       |           |
|---------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| - Zëvendësministrin e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit               | kryetar;  |
| - Katër përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit | anëtarë;  |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë                                        | anëtar;   |
| - Një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave       | anëtar;   |
| - Një përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse në fushën e bujqësisë organike       | anëtar;   |
| - Një përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës                                 | anëtar.”. |

2. Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Sekretariati përbëhet nga tre anëtarë, specialistë nga drejtoritë e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të cilët përcaktohen me urdhër të Ministrit. Sekretariati përgatit dokumentet dhe materialet për mbledhjen e KSHPO-së, administron dokumentet dhe aktet, që miratohen nga KSHPO-ja, si dhe nxjerr buletinin e këtij komisioni. Mënyra e funksionimit të sekretariatit përcaktohet me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

3. Në pikën 8 “Detyrat dhe të drejtat e KSHPO-së janë:” bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjat “f”, “h” dhe “j”, fjalët “...Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit...” zëvendësohen me... “Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit...”.

b) Në shkronjën “k”, fjalët “...nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit...”.

zëvendësohen me "...nga buxheti i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit...".

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"9. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.147, datë 8.3.2006**

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË ARSIMIT DHE TË SHKENCËS TË KRYEJË  
PROCEDURAT E PROKURIMIT, NË EMËR TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË,  
PËR NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E OBJEKTEVE SHKOLLORE, PËR  
FURNIZIMIN ME MJETE DIDAKTIKE, DEMONSTRATIVE DHE DOKUMENTACION  
SHKOLLOR, SIPAS NEVOJAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, që, për fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2006, për institucionet në varësi të saj, të kryejë procedurat e prokurimit, në emër të këtyre institucioneve, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore, për furnizimin me mjete didaktike, demonstrative dhe dokumentacion shkollor, sipas nevojave, të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës të prokurojë fondin e përgjithshëm, të llogaritur si shumë e fondeve buxhetore, të miratuara për çdo ent varësie, në Buxhetin e Shtetit të vitit 2006, për ndërtimet, rikonstruksionet, si dhe mallrat e përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kontratat me subjektet fituese, pas përfundimit të procedurave të prokurimit nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, të lidhen nga institucionet, në emër të të cilave është zhvilluar prokurimi, për fondin e vënë në dispozicion dhe sipas nevojave të paraqitura prej tyre.

4. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**LISTA E PROKURIMEVE PUBLIKE QË DO TË PËRQËNDROHEN PËR T'U ZHVILLUAR  
NË MINISTRINË E ARSIMIT**

| Nr. | Objekti i prokurimit                                | Fondi limit i përgjithshëm |           | Koha e zhvillimit të tenderit | Procedura e prokurimit | Burimi i financimit |
|-----|-----------------------------------------------------|----------------------------|-----------|-------------------------------|------------------------|---------------------|
|     |                                                     | Investime                  | Shpenzime |                               |                        |                     |
|     | NDËRTIME DHE RIKONSTRUKSIONE                        |                            |           |                               |                        |                     |
| A.  | Objekte në funksion të arsimit të mesëm profesional |                            |           |                               |                        |                     |
| 1   | Rik shk mesme H.Turizmi Tiranë                      | 60 000 000                 |           | Maj 2006                      | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 2   | Rik shk.mesme Futbollit Tiranë                      | 70 000 000                 |           | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |
| 3   | Sistemi ngrohje Konv, Ped Elbasan                   | 13 000 000                 |           | Prill 2006                    | T.H.përq në MASH       | Buxhet Shteti       |

|                                                           |                                                                 |            |            |            |                  |               |
|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|------------|------------|------------|------------------|---------------|
| 4                                                         | Sistem ngrohje konvikt dhe shk.prof.të rik 2005, Korçë          | 12 900 000 |            | Maj 2006   | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |
| 5                                                         | Konv shk mes "Demir Progri", Korçë                              | 20 500 000 |            | Maj 2006   | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |
| 6                                                         | Shkolla mesme pyjore Shkodër                                    | 25 000 000 |            | Prill 2006 | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |
| 7                                                         | Sistemi i ngrohjes Konvikte+shkolla prof të rik në vitin 2005,Q | 20 000 000 |            | Maj 2006   | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |
| 8                                                         | Rikonstrukcion i shkollës së mesme industriale, Vlorë           | 27 000 000 |            | Prill 2006 |                  |               |
| MALLRA                                                    |                                                                 |            |            |            |                  |               |
| Mallra në funksion të arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm |                                                                 |            |            |            |                  |               |
| 1                                                         | Blerje mjete didaktike, arsimit bazë                            |            | 96 000 000 | Prill 2006 | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |
| 2                                                         | Blerje mjete didaktike, arsimit i mesëm                         |            | 25 000 000 | Prill 2006 | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |
| 3                                                         | Dokumentacion shkollor (dëftesa, regjistra etj.)                |            | 18 820 000 | Mars 2006  | T.H.përq në MASH | Buxhet Shteti |

**Fletorja Zyrtare gjendet:** duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

### **BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:**

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

|                                                                 |      |
|-----------------------------------------------------------------|------|
| 1. PROKURIMIN                                                   | 1500 |
| PUBLIK.....                                                     |      |
| 2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)                                | 600  |
| .....                                                           |      |
| 3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të)..... | 1500 |
| 4. TAKSAT DHE TATIMET...(suplement                              | 1500 |
| 2006).....                                                      |      |
| 1. TREGUESI KRONOLOGJIK I                                       | 1500 |
| LEGJISLACIONIT.....                                             |      |
| 2. TREGUESI TEMATIK I                                           | 2000 |
| LEGJISLACIONIT.....                                             |      |

### **DOLI NGA SHTYPI:**

|                                                        |      |
|--------------------------------------------------------|------|
| 1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... | 500  |
| 2. KODI                                                | 1000 |
| DOGANOR.....                                           |      |
| 3. KODI DETAR                                          | 1000 |
| .....                                                  |      |

Doli nga shtypi më 17.3.2006

|                    |                  |
|--------------------|------------------|
| Tirazhi: 4000 copë | Formati: 60x88/8 |
|--------------------|------------------|

Shtypshkronja “Mësonjëtorja”  
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë